

STATUT
I
KËRKIMEVE UNIVERSITARE CO. LLC

KJO MARRËVESHJE PËR VEPRIMTARINË u lidh me 31 korrik 1998, nga i nënshkruari:

NDËRKOHË që i nënshkruari dëshiron të formojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për qëllimet e parashtruara në Nenin 4 të këtij dokumenti, në përputhje me Ligjin (siç përkufizohet më poshtë), dhe ligjeve të tjera përkatëse të Shtetit të Maryland-it; dhe

NDËRKOHË i nënshkruari dëshiron të parashtrojë më poshtë marrëveshjet dhe kuptimin e vet në lidhje me Shoqërinë (siç përkufizohet më poshtë).

TANI, PËR PASOJË, duke marrë parasysh çfarë u parashtrua më lart, premtimet e dyanshme në vijim dhe konsiderata të tjera të dobishme dhe me vlerë, marrja dhe mjaftueshmëria e të cilave njihen prej këtij dokument, i nënshkruari, duke qenë i ndërgjegjshëm se përbën detyrim ligjor, miraton çka vijon më poshtë si “marrëveshje për veprimtarinë” e Shoqërisë (në kuptimin që kjo shprehje përdoret në Ligj):

1. **Përkufizime.** Fjalët dhe shprehjet që vijojnë do të kenë kuptimet që jepen në vijim, në rastet kur do të përdoren më poshtë:

A. “Ligj” do të thotë dhe i referohet Ligjit të Maryland-it për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar [§ 4A-101 et.seq. të Ligjit të Maryland-it, Korporatat dhe Shoqatat] (1993)], si dhe ndryshimeve që mund t’i bëhen atij kohë pas kohe.

B. “Marrëveshje” do të thotë dhe i referohet kësaj Marrëveshjeje për Veprimtarinë dhe Ekspozatit A bashkëngjitur, si dhe ndryshimeve, me shkrim, që mund t’u bëhen kohë pas kohe.

C. “Statuti” do të thotë dhe i referohet Statutit të Organizimit të Shoqërisë, të dorëzua në, dhe të aprovuara nga Departamenti i Tatimeve dhe Taksave të Maryland-it me 31 korrik 1998,)], si dhe ndryshimeve që mund t’i bëhen kohë pas kohe.

D. “Bordi i Drejtorëve” do të thotë dhe i referohet personave të caktuar nga Anëtari, sipas § 10A në vijim.

E. “Llogari e Kapitalit” do të, në lidhje me Anëtarin dhe aty ku ka kuptim përsa u takon taksave mbi të ardhurat, do të thotë dhe i referohet “librit” të veçantë të llogarive për Anëtarin, libër i cili do të krijohet dhe mbahet në të gjitha rastet, në mënyrën e përshkruar këtu më poshtë, dhe në përputhje me Rregulloren e Thesarit § 1.704-1(b)(2)(iv), dhe me ndryshimet, dhe në përputhje me dispozitat e tjera Rregullores së Thesarit § 1.704-1(b), të cilat duhet të zbatohen, në mënyrë që Llogaria e Kapitalit të

përcaktohet dhe të mbahet në përputhje me dispozitat e Rregullores së Thesarit § 1.704-1(b)(2)(iv).

F. “Kontribut Kapital” ose “Kontribute Kapitale” aty ku është rasti, do të thotë dhe i referohet shumës në para dhe/ose vlera e tregut e pronës (duke zbritur borxhin, nëse ka, e Anëtarit, i cili është marrë në punë nga Shoqëria dhe/ose borxhin, nëse ka, e pronës në datën e kontributit, pa marrë parasysh dispozitat e I.R.C. Seksioni 7701 (g)), që aktualisht është derdhur nga Anëtari i kapitalit të Shoqërisë, si dhe çfarëdo kontributesh të tjera që janë bërë sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çfarëdo shume të paguar nga Anëtari në lidhje me ndonjë ankesë, borxh apo detyrim kundër, apo të, Shoqërisë dhe/ose në bazë të çfarëdo garancie borxhi të paraqitur nga Shoqëria apo përndryshe, nga Anëtari.

G. “Shoqëria” do të thotë dhe i referohet Kërkimeve Universitare Co., LLC, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e Maryland-it, e krijuar sipas dhe në përputhje me, Ligjin dhe ligje të tjera përkatëse të Shtetit të Maryland-it.

H. “Viti Kontabël i Shoqërisë” do të thotë dhe i referohet vitit kontabël të shoqërisë, që mbyllet me 30 shtator të çdo viti.

I. “Kapitalet e Shoqërisë”, në çfarëdo kohe, do të thotë dhe i referohet çdonjërit apo të gjithë kapitaleve ose pronave (fizike ose jo, në zotërim të plotë apo të marrë hua, egzistuese apo te se ardhmes, të Shoqërisë.

J. “Eksponati A” do të thotë dhe i referohet Eksponatit A të kësaj Marrëveshjeje, që lidhet me emrin, adresën dhe Interesin e Shprehur në Përqindje të Anëtarit, si dhe ndryshimeve që mund t’u bëhen kohë pas kohe.

K. “Interesi” në Shoqëri do të thotë dhe i referohet të gjithë interesit të pronësisë së Anëtarit të Shoqërisë në çfarëdo kohë, përfshirë të drejtën e Anëtarit për të pasë përfitimet, së bashku dhe veç e veç, të cilat i takojnë sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe Ligjit, së bashku me detyrimet e Anëtarit për të respektuar të gjithë kushtet dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Ligjit.

L. “Humbje” do të ketë kuptimin që i është dhënë kësaj fjale në §7A më poshtë.

M. “I.R.C.” do të thotë dhe i referohet Kodit të të Ardhurave të Brendshme të vitit 1986, dhe ndryshimeve të bëra kohë pas kohe, ose çdo ligji të ngjashëm federal për të ardhurat e brendshme, që është në fuqi në vend të Kodit të të Ardhurave të Brendshme të vitit 1986, si dhe ligjit korrespondues mbi të ardhurat e brendshme (dhe paragrafeve të tij) të çdo shteti apo juridiksioni.

N. “Anëtar” ose “Anëtarët” do të thotë dhe i referohet atij Personi, ose atyre Personave të caktuar si të tillë në Eksponatin A bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

O. “Qarkullimi i Parave Neto” do të thotë dhe i referohet të gjitha

të ardhurave në para të Shoqërisë (siç janë, por pa u kufizuar në, të ardhurat totale nga operimet, të ardhurat totale nga shitjet, të ardhura nga kredi apo rifinancimi, dhe çdo shumë parash që vjen nga Kontributet në Kapital të Anëtarit), plus çdo fond tjetër (përfshirë shumat që janë vënë mënjanë më parë nga Anëtari si fond rezervë, dhe në atë masë që Anëtari nuk e konsideron, në mënyrë të arsyeshme, atë fond rezervë si të nevojshëm për biznesin dhe veprimtarinë e Shoqërisë), të gjykuar si të disponueshëm për t'u shpërndarë dhe përcaktohen si Qarkullim Parash Neto nga Anëtari i Bordit të Drejtorëve nëse delegohet nga Anëtari, minus disbursimet totale në para të kryera nga Shoqëria (siç janë, por pa u kufizuar në, shpenzimet operuese të Shoqërisë dhe ripagimi i kredive apo huave të dhëna në favor të Shoqërisë nga çfarëdo Person (përfshirë Antarin), minus rezervat apo përdorimet e tjera në parave që Anëtari i Bordit të Drejtorëve, në atë masë që i është deleguar ky autoritet nga Anëtari, do të gjykojë të nevojshëm për biznesin dhe veprimet e Shoqërisë.

P. "Përqindje Interesi" të një Anëtari do të thotë dhe i referohet pjesëmarrjes në Shoqëri të Anëtarit, të shprehur në përqindje, siç paraqitet përkundrejt emrit të Anëtarit nën shtyllën "Përqindje Interesi" në Eksponatin A bashkëngjitur këtij dokumenti, dhe kjo përqindje mund të ndryshohet kohë pas kohe në përputhje me dispozitat e paraqitura këtu.

Q. "Person" do të thotë dhe i referohet një individ apo enti, siç është, por pa u kufizuar në, një korporatë, shoqëri me partneritet të përgjithshëm, shoqëri e përbashkët, shoqëri me pjesëmarrje të kufizuar, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, trust apo shoqatë biznesi.

R. "Fitim" do të ketë kuptimin që i jepet kësaj fjalë në § 7A më poshtë.

S. "Anëtar(ë) të Zëvendësuar" do të thotë dhe i referohet atij Personi apo atyre Personave, të cilët pranohen si anëtarë të Shoqërisë në përputhje me dispozitat e Nenit 12 më poshtë dhe që pasqyrohen në Eksponatin A.

2. Emri i Shoqërisë. Emri i Shoqërisë do të jetë "Kërkime Universitare Co., LLC".

3. Krijimi i Shoqërisë. Anëtarët e nënshkruar më poshtë në këtë document, kanë autorizuar Tucker, Flyer^Leëis, një korporatë profesionale, të veprojnë si organizatorë në mënyrë që të krijojnë Shoqërinë nën dhe në bazë të Ligjit, nëpërmjet paraqitjes së Statutit. Kjo Marrëveshje është subjekt i, dhe drejtohet nga, Ligji dhe Statuti. Në rast të një konfliktit të drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe, ose dispozitave të detyrueshme të Ligjit apo të Statutit, këto dispozita të detyrueshme të Ligjit apo të Statutit, sipas rastit, do të jenë mbizotëruese.

4. Qëllimet e Shoqërisë. Qëllimi i përgjithshëm i Shoqërisë është pasja dhe ushtrimi, së bashku dhe veç e veç, i të gjitha fuqive dhe privilegjeve që sot dhe më pas i

takojnë shoqërive me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve në përgjithësi të Shtetit të Maryland-it.

5. “Zyra Qendrore; Përfaqësuesi Rezident”. Zyra qendrore e Shoqërisë do të ndodhet në adresën 7200 Wisconsin Avenue, Suite 600, Bethesda, Maryland 20814. Anëtari mund të ndryshojë zyrën qendrore të Shoqërisë, dhe/ose të hapë zyra të tjera shtesë të Shoqërisë, Brenda ose jashtë Shtetit të Maryland-it, siç mund ta gjykojë ai me vend. Përfaqësuesi resident i Shoqërisë në Shtetin e Maryland-it, do të jetë Melvyn J. Estrin, i cili është resident në Shtetin e Maryland-it. Adresa e përfaqësuesit resident të Shoqërisë është 7200 Wisconsin Avenue, Suite 600, Bethesda, Maryland 20814.

6. Kontributet Kapitale.

A. Në rastin që në çdo kohë (ose kohë pas kohe) kërkohen fonde nga shoqëria për, ose në lidhje me biznesin apo veprimtarinë e saj (“Fondet”), atëherë Anëtari, i cili vepron për interes të, dhe në emër të Shoqërisë do të ketë të drejtën të bëjë që Shoqëria të marrë hua Fondet me ato përqindje interesi që do të jenë në fuqi në atë kohë, nga Banka Tregtare, Banka Krediti dhe Kursimesh dhe ose /institucione të tjera huadhënëse ose Persona të tjerë (duke përfshirë Anëtarin). Në rast se Anëtari nuk bën zgjedhjen që shkakton huazimin e Fondeve nga Shoqëria në përputhje me dispozitat e këtij § 6A, Anëtari mund të kontribuojë në kapitalin e Shoqërisë Fondet, të cilat pas kësaj do të kreditohen si kontribut në kapitalin e Shoqërisë dhe të bëhen pjesë e Llogarisë së Kapitalit të Anëtarit në datën e këtij kontributi..

B. Dispozitat e këtij Neni 6 nuk synojnë të jenë në dobi të, ose të detyrueshme nga çdonjë kreditor apo Person tjetër (përveç Anëtarit në rolin e tij si anëtar), kundrejt të cilit Shoqëria ose Anëtari ka borxhe ose detyrime (ose përndryshe ai ka ndonjë pretendim për to); asnjë kreditor apo person tjetër i tillë nuk do të ketë ndonjë të drejtë të drejtë sipas kësaj dispozite paraardhëse apo duke duke u mbështetur në këto dispozita paraardhëse të ngrrejë ndonjë pretendim për ndonjë borxh apo detyrim kundrejt Shoqërisë ose Anëtarit.

C. Anëtarit nuk do t’i kërkohet të derdhë Kontribute Kapitale në favor të kompanisë përtej shumave të parashtruara në këtë Nen 6, por ai mund ta bëjë këtë me zgjedhje të lirë.

D. Anëtari nuk do të jetë personalisht përgjegjës për humbjet, kostot, shpenzimet, borxhet ose detyrimet e Shoqërisë përtej Kontributeve të veta Kapitale.

F. Anëtarit nuk do t’i paguhet asnjë interes i lidhur me Kontributin e tij Kapital apo llogarinë e tij të Kapitalit.

7. Caktimi i Fitimit dhe Humbjes

A. Për qëllimet e këtij neni 7 dhe aty ku është e përshtatshme, “Fitim” dhe “Humbje” do të nënkuptojë, për çdo vit Vit Kontabël të Shoqërisë apo periudhë tjetër, një shumë të barabartë me të ardhurat e tatueshme, fitimet, humbjet apo zbritjet të Shoqërisë, për atë vit apo periudhë e përcaktuar në përputhje me I.R.C Seksioni 703 (a), me ndryshimet që vijnë:

(1) Të gjitha të ardhurat apo fitimet e Shoqërisë që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin sipas ligjeve federale dhe që nuk janë marrë në konsideratë në llogaritjen e Fitimit dhe të Humbjes sipas këtij Neni §7A do t’u shtohen të ardhurave të tatueshme, fitimeve, humbjeve apo zbritjeve.

(2) Çdo shpenzim i Shoqërisë siç përshkruhet në I.R.C Seksioni 705 (a)(2)(B) apo trajtohet si shpenzim nga ato që përshkruhen në këtë Seksion dhe që nuk është marrë në konsideratë në llogaritjen e Fitimit dhe të Humbjes sipas këtij Neni §7A do t’u zbriten të ardhurave të tatueshme, fitimeve, humbjeve apo zbritjeve.

B Pjesët që shpërndahen për çdo zë të fitimit dhe humbjes, për çdo Vit Kontabël të Shoqërisë apo periudhë tjetër do t’i kalojë llogarisë së Anëtarit.

C Në se gjatë një Viti Kontabël të Shoqërisë transferohet ose caktohet një Interes, ajo pjesë e çfarëdo zëri të Fitimit, Humbjes, të ardhurave, fitimeve, zbritjeve, kreditit apo bazës së caktuar sipas këtij Neni 7 që lidhet me Interesin e transferuar, në diskrecionin e vetëm të Anëtarit ose (i) do të bazohet në segmentimin e Vitit Kontabël të Shoqërisë ndërmjet transferuesit dhe marrësit, ose (ii) të ndahet ndërmjet transferuesit dhe marrësit në proporcion me numrin e ditëve të këtij Viti Kontabël të Shoqërisë gjatë të cilave secili e ka zotëruar këtë Interes, ashtu siç pasqyrohet në regjistrat dhe të dhënat e Shoqërisë.

8. Shpërndarja e Qarkullimit të Parave Neto . Përveç masës në të cilën Qarkullimi i Parave Neto do të shpërndahet pas mbylljes së Shoqërisë sipas § 13B më poshtë, Qarkullimi i Parave Neto të Shoqërisë do t’i shpërndahet Anëtarit në atë kohë dhe në ato shuma që Anëtari e gjykon të përshtatshme.

9. Titulli Ligjor mbi Aktivet e Shoqërisë

A. Titulli Ligjor mbi Aktivet e Shoqërisë do të mbahet në emër të Shoqërisë ose në çdo mënyrë tjetër që Anëtari e vendos se është në interesin më të mirë të Shoqërisë.

B. Është shprehimisht e përcaktuar dhe është rënë dakord që mënyra e ruajtjes së titullit mbi Aktivet e Shoqërisë (ose të çdo pjese të tyre) zgjidhet vetëm në dobi të Shoqërisë. Në përputhje me këtë, aksionarët, pasardhësit ose të caktuarit nga Anëtari nuk do të kenë të drejtë, titull apo interes në asnjë prej Aktiveve të Shoqërisë për arsye të mënyrës së mbajtjes së këtij titull; përkundrazi, Aktivet e Shoqërisë do të jenë subjekt i kësaj Marrëveshjeje. Më tej është kuptuar dhe rënë dakord që Interesi i Anëtarit do të konsiderohet pronë personale dhe jo interes mbi pronën e patundshme, në atë masë

që çdonjë ose të gjithë Aktivet e Shoqërisë të përbëjnë pronë të patundshme. Në përputhje me këtë, Anëtari nuk do të ketë të drejtën të kërkojë një ndarje të Aktiveve të Shoqërisë (apo të çdo pjese të tyre).

10. Manaxhimi; Dëmshpërblimi

A. Shoqëria do të manaxhohet nga Anëtari. Pavarësisht nga kjo, Anëtari mund t'i delegojë tagrën për manaxhimin e biznesit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë si dhe për marrjen e çdo vendimi mbi çështjet e specifikuar në këtë Marrëveshje një Bordi Drejtorësh, i cili do të caktohet nga Anëtari, dhe që mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e Anëtarit për drejtimin e biznesit dhe veprimtarisë së Shoqërisë dhe të kryejë të gjitha veprimet e ligjshme dhe gjërat, të cilat nuk parashikohen nga Ligji apo Statuti apo kërkon që të ushtrohen apo zbatohen prej tij, ose që i janë dhënë apo rezervuar Anëtarit: megjithatë, me kusht që, duke përcjellë një tagër të tillë, Anëtari duhet të ketë të drejtën të shpërfillë secilin prej, ose të gjitha verpimet e Bordit të Drejtorëve. Numri i drejtorëve dhe koha e qëndrimit në detyrë e secilit prej tyre do të përcaktohet herë pas here nga Anëtari. Në çdo takim me Anëtarin, Anëtari mund të shkarkojë nga detyra, në çdo kohë, secilin prej drejtorëve ose drejtorët, me ose pa shkak dhe mund të zgjedhë një pasardhës ose pasardhësit për të mbushur cdo boshllëk ose boshllëqe që vjen si pasojë e mandatit të papërfunduar të ndonjë drejtori apo drejtorëve të shkarkuar nga detyra. Çdo drejtor mund të japë dorëheqjen në çdo kohë duke dhënë një njoftim me shkrim Bordit të Drejtorëve, Presidentit apo Sekretarit të Shoqërisë. Përveçse kur specifikohet ndryshe në një njoftim të tillë me shkrim, dorëheqja do të hyjë në fuqi mbas dorëzimit të njoftimit në fjalë në Bordin e Drejtorëve apo nëpunësin e caktuar për këtë. Nuk do të jetë e nevojshme të pranohet dorëheqja para kohës që ajo hyn në fuqi. Bordi i Drejtorëve do të caktojë rregullat e veta proceduriale dhe do të mbledhet në kohën dhe vendet që do të parashikohen nga këto rregulla apo që do të vendoset nga Bordi i Drejtorëve. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve mund të thirren nga Kryetari i Bordit, Presidenti apo nga dy (2) ose më shumë drejtorë, duke lajmëruar së paku dy (2) ditë përpara secilin prej drejtorëve, nëse lajmërimi bëhet personalisht, ose së paku tre (3) ditë përpara nëse njoftimi dërgohet me postë. Nuk është e nevojshme që njoftimi të përmbajë qëllimin apo qëllimet e mbledhjes. Në të gjitha mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, përveçse kur Anëtari jep udhëzim të ndryshëm, një shumicë e numrit të drejtorëve që janë në detyrë në atë kohë do të përbëjë kuorum për kryerjen e biznesit dhe vendimi i një shumice të drejtorëve të pranishëm në çfarëdo mbledhje në të cilën ka një kuorum, do të jetë edhe vendimi i Bordit të Drejtorëve. Çdo veprim, i cili kërkohet, apo lejohet të ndërmerret në çfarëdo mbledhje të Anëtarit, apo të Bordit të Drejtorëve, mund të ndërmerret pa bërë mbledhje, në rast se jepet një lejë me shkrim për këtë veprim, e nënshkruar, sipas rastit, nga Anëtari apo të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, dhe një lejë e tillë me shkrim depozitohet në dokumentacionin e veprimtarisë së Anëtarit ose Bordit të Drejtorëve.

B. Punonjësit e Shoqërisë do të përzgjidhen nga Bordi i Drejtorëve dhe do të ushtrojnë ato kompetenca e kryejnë ato detyra, siç do të vendoset nga Bordi i Drejtorëve kohë pas kohe, si në vijim:

(1) Bordi i Drejtorëve do të përzgjedhë një President, një Sekretar dhe një Ruajtës Thesari. Gjithashtu, Bordi i Drejtorëve mund të përzgjedhë një Kryetar të Bordit, një ose më shumë Zëvendës President, një ose më shumë Ndhmës Sekretar dhe/ose Ndhmës Ruajtës Thesari, dhe dhe punonjës të tjerë siç do ta shohë të nevojshme apo të përshtatshme. Një individ mund të mbajë çfarëdo numër ofiqesh, përveç rastit kur Ligji apo Statuti parashikojnë ndryshe.

(2) Çdo punonjës i Shoqërisë do të mbajë postin e vet deri para (a) dorëheqjes së tij, dhe (b) në atë kohë që përzgjidhet dhe kualifikohet pasardhësi i tij. Çdo punonjës i zgjedhur apo caktuar nga Bordi i Drejtorëve mund të hiqet në çdo kohë nga drejtorët, me ose pa shkak. Çdo boshllëk i krijuar në ndonjë post të Shoqërisë, qoftë për arsye të heqjes, dorëheqjes, apo arsye tjetër, mund të plotësohet nga drejtorët, për atë kohë që ka mbetur pa u konsumuar në këtë post.

(3) Kryetari i Bordit, nëse ka, do të jetë punonjës i Shoqërisë dhe, nën drejtimin e Bordit të Drejtorëve, do të kryejë ato funksione dhe detyra ekzekutive, mbikqyrëse dhe manaxhimi siç mund t'i jepen kohë pas kohe nga Bordi i Drejtorëve.

(4) Presidenti do të ketë detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

(a) Presidenti do të jetë punonjësi kryesor ekzekutiv i Shoqërisë dhe, nën drejtimin e Bordit të Drejtorëve, do të ketë detyrat kryesore për sa i përket biznesit, çështjeve dhe pronave të Shoqërisë dhe mbikqyrjen e përgjithshme mbi punonjësit dhe përfaqësuesit e tjerë. Presidenti do të kujdeset që të gjithë urdhrat dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve vihen në zbatim. Përveç këtyre, por pa krijuar kufizim mbi sa u tha më sipër, Presidenti do të fuqizohet të autorizojë çdo ndryshim në regjistrimin e zyrës apo regjistrimin e përfaqësuesit (ose të dyja bashkë) të Shoqërisë.

(b) Përveç rastit kur Bordi i Drejtorëve vendos ndryshe, Presidenti do të ketë fuqi dhe autoritet të plotë që, në emër të Shoqërisë, të marrë pjesë, veprojë dhe votojë në çfarëdo mbledhje të aksionerëve të korporatave të tjera në të cilat Shoqëria mund të ketë tituj pronësie. Në mbledhje të tilla, Presidenti do të ketë dhe mund të ushtrojë çdonjë prej dhe të gjitha të drejtat dhe kompetencat që rrjedhin nga pronësia mbi ato tituj pronësie, të cilët Shoqëria mund të zotërojë dhe të cilat do t'i ushtronte po të ishte e pranishme. Kohë pas kohe, Bordi i Drejtorëve mund t'u përcjellë fuqi të tilla çdonjë apo disa personave të tjerë.

(5) Zëvendës-presidenti, në rast se ekziston një i tillë, (ose në rast se ekziston më shumë se një, Zëvendës-presidentët, në renditjen e përcaktuar, ose, në mungesë të ndonjë renditjeje, në rendin sipas të cilit janë zgjedhur), në mungesë të Presidentit ose në rast paaftësie për punë të tij, do të përmbushë detyrat dhe të ushtrojë fuqitë e Presidentit dhe përgjithësisht do të ndihmojë Presidentin dhe do të përmbushë detyra të tjera të tilla dhe të ketë fuqi të tjera të tilla, të cilat mundet, kohë pas kohe, t'i përcillen nga Bordi i Drejtorëve.

(6) Sekretari duhet të marrë pjesë në të gjitha takimet e Bordit të Drejtorëve dhe në të gjitha takimet e aksionerëve dhe të protokollojë të gjitha votat dhe procesverbalet e takimeve në një regjistër bllok që duhet të mbahet për këtë qëllim. Ai do të japë ose do të detyrohet të japë njoftime për të gjitha takimet e Anëtarëve dhe ato të Bordit të Drejtorëve, dhe do të përmbushë detyra të tjera të tilla të cilat mundet, kohë pas kohe, t'i përcillen nga Bordi i Drejtorëve, Kryetari i Bordit të Drejtorëve, ose Presidenti, nën mbikqyrjen e të cilëve ai do të të veprojë.

(7) Zëvendëssekretari, në rast se ka një të tillë (ose në rast se ka më shumë se një, Zv/sekretarët në renditjen e përcaktuar, ose, në mungesë të ndonjë renditjeje, në rendin sipas të cilit janë zgjedhur), në mungesë të Sekretarit ose në rast paaftësie për punë të tij, do të përmbushë detyrat dhe të ushtrojë fuqitë e Sekretarit dhe do të përmbushë detyra të tjera të tilla dhe të ketë fuqi të tjera të tilla, të cilat mundet, kohë pas kohe, t'i përcillen nga Bordi i Drejtorëve.

(8) Thesarmbajtësi do të ketë kujdestarinë e të gjitha fondeve dhe pasurive të tjera me vlerë të Shoqërisë, përfshirë letrat me vlerë, dhe duhet të mbajë llogari të plota dhe të sakta të dëftësave dhe derdhjeve në regjistrat që i përkasin Shoqërisë dhe duhet të depozitojnë të gjitha shumat dhe pasuri të tjera me vlerë në emër dhe në kreditë e Shoqërisë në ato llogari, të cilat mundet që herë pas here të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve. Ai do të depozitojë fondet e Shoqërisë siç mund të urdhërohet nga Bordi i Drejtorëve, të marrë dëftesat për derdhje të tilla dhe duhet të japë llogari para Kryetarit të Bordit, Presidentit dhe Bordit të Drejtorëve, në mbledhjet e Bordit, ose kurdo që ta kërkojnë ato, për të gjitha transaksionet e kryera prej tij si Thesarmbajtës dhe për gjendjen financiare të Shoqërisë.

(9) Zv/mbajtësi i Thesarit, në se ekziston një i tillë (ose në rast se ka më shumë se një, Zëvendësmbajtësit e Thesarit në renditjen e përcaktuar, ose, në mungesë të ndonjë renditjeje, në rendin sipas të cilit janë zgjedhur), në mungesë të Thesarmbajtësit ose në rast paaftësie për punë të tij, do të të përmbushë detyrat dhe të ushtrojë fuqitë e Thesarmbajtësit dhe do të përmbushë detyra të tjera të tilla dhe të ketë fuqi të tjera të tilla, të cilat mundet, kohë pas kohe, t'i përcillen nga Bordi i Drejtorëve.

C. Në vijim të dispozitave të §§10A dhe 10B më poshtë, Shoqëria mund të paguajë tarifa për kompensim, kamatë ose shpërblim për Anëtarin, për çdo ent në të cilin Anëtari mund të ketë ndonjë interes dhe çfarëdo anëtari të Bordit të Drejtorëve, nëpunës, punonjës dhe agjent të Shoqërisë për kryerjen e çdonjërit dhe të gjithë shërbimeve që lidhen me biznesin dhe veprimet e Shoqërisë.

D. Anëtari dhe anëtarët e Bordit të Drejtërovë, si dhe nëpunësit, punonjësit dhe agjentët e shoqërisë do të rimbursohen totalisht dhe krejtësisht nga Shoqëria për çdonjë dhe të gjithë kostot dhe shpenzimet nga xhepi të shkaktuara çdonjërit prej Personave të sipërpërmendur në lidhje me krijimin e Shoqërisë, blerjen ose shitjen nga Shoqëria të çdonjërit nga Aktivet e Shoqërisë, dhe /ose manaxhimin dhe mbikqyrjen e biznesit të Shoqërisë; megjithatë me kusht që në lidhje me këto kosto dhe shpenzime

nga xhepi çdo Person i tillë do t'i paraqesë Shoqërisë faturat apo çdo dokument tjetër përkatës në ato detaje apo forma, të cilat, me arsye, janë të nevojshme të justifikojnë këto kosto dhe shpenzime nga xhepi.

E. Anëtari, anëtarët e Bordit të Drejtorëve, si dhe nëpunësit, punonjësit dhe përfaqësuesit e Shoqërisë do të dëmshpërblehen dhe do t'u sigurohet paprëkshmëria nga Shoqëria në lidhje çfarëdo dhe të gjitha pretendimet, kërkesat, borxhet, kostot, shpenzimet, dëmet dhe pasojat e veprimeve të çfarëdolloj natyre, që rrjedhin nga, ose që vijnë si pasojë e manaxhimit dhe mbikqyrjes së biznesit të veprimtarisë së Shoqërisë, ose përndryshe siç parashikohet në Ligj.

(1) Anëtari, drejtori, nëpunësi, punonjësi dhe përfaqësuesi nuk do të jenë përgjegjës për dëmet kundrejt Anëtarit ose Shoqërisë për çdo veprim të kryer brenda gamës së kësaj Marrëveshjeje, me qëllim të mirë dhe në një mënyrë që me arsye besoj se ishte në interesin më të mirë, ose jo kundër interesit më të mirë të Shoqërisë.

(2) Dëmshpërblimi i autorizuar nga kjo § 10E do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në, pagimin e (a) tarifave të avokatit ose shpenzimeve të tjera të arsyeshme të shkaktuara në lidhje me zgjidhjen e çështjes me rrugë gjyqësore, dhe (b) heqjen e çdo barre që bie mbi çfarëdo pronë të të dëmshpërblyerit.

(3) Të drejtat për dëmshpërblim që përmbahen në këtë § 10E do të jenë në shtesë të, dhe bashkë me çdonjë dhe të gjitha të drejtat dhe masat ndihmëse të cilat i takojnë Anëtarit, drejtorit, nëpunësit, punonjësit dhe përfaqësuesit, të drejta dhe masa, të cilat, në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, shprehen në masa ligjore ose në shuma parash. Dëmshpërblimet do të jepen vetëm dhe krejtësisht nga Aktivet e Kompanisë dhe asnjë Anëtar, drejtor, nëpunës, punonjës apo përfaqësues nuk do të mbahet personalisht përgjegjës kundrejt çfarëdo të dëmshpërblyeri sipas këtij § 10E. Përveç kësaj, dispozitat e këtij § 10E nuk kanë synim të jenë në dobi të ndonjë kreditori apo personi tjetër, kundrejt të cilit i dëmshpërblyeri ka ndonjë borxh apo detyrim (apo përndryshe kundrejt të cilit kreditori apo personi kanë pretendime për borxh apo detyrim); gjithashtu asnjë kreditor apo person i tillë nuk do të ketë asnjë të drejtë mbi Shoqërinë apo cilindo nga Anëtarët, që të rrjedhë nga dispozitat e këtij §10E dhe që të vijë si pasojë e ndonjë borxhi apo detyrimi (apo pretendimi për to) që i dëmshpërblyeri ka kundrejt kreditorit apo personit të tillë.

11. Llogaritë Bankare, Kontabiliteti dhe Të Dhënat.

A. Fondet e Shoqërisë do të depozitohen në atë ose ato llogari bankare të Shoqërisë, siç do të vendoset nga Anëtari.

B. Regjistrat dhe të dhënat e Shoqërisë, dhe situata financiare dhe rezultatet e veprimeve të saj do të mbahen e shënohen në përputhje me rregullat e mbajtjes së kontabilitetit që zgjidhen nga Shoqëria. Regjistrat dhe të dhënat e Shoqërisë do të pasqyrojnë të gjithë transaksionet e Shoqërisë dhe do të mbahen në mënyrë të duhur dhe të përshtatshme për biznesin e Shoqërisë. Viti fiskal i Shoqërisë për qëllime të

raporteve financiare dhe tatimit mbi fitimin do të përputhet me Vitin Kontabël të Shoqërisë.

C. Shoqëria do të mbajë në zyrën e saj qendrore ose në ato zyra të tjera shtesë (Brenda ose jashtë Shteteit të Maryland-it), siç do ta gjykojë Anëtari të përshtatshme, (i) regjistrat dhe të dhënat ku do të pasqyrohet lista më e fundit emërore e secilit Anëtar bashkë me adresat e tyre, (ii) një kopje e Statutit dhe e kësaj Marrëveshjeje si dhe gjithë ndryshimet që mund t'u jenë bërë të dy këtyre dokumenteve, (iii) kopje të faturave të pagesës së tatimit mbi fitimin të Kompanisë, në nivel federal, shteti dhe local, dhe tatimit mbi pronën personale, fizike ose jo, nëse aplikojnë, për tre (3) Vitet e fundit Kontabël të Shoqërisë, (iv) kopje të deklarimeve financiare të Shoqërisë nëse ka, për tre (3) Vitet e fundit Kontabël të Shoqërisë, në të cilët pasqyrohet gjendja e biznesit dhe situata financiare gjatë periudhave të sipërpërmendura, (v) çdo informacion tjetër dhe/ose të dënata që kërkohen nga Ligji.

D. Anëtari, (ose çdonjë prej tyre) mund të detyrojë Shoqërinë të regjistrojë të gjitha kalimet për qëllim të tatimit mbi fitimin në nivel federal, me kusht që, megjithatë, në rast të një transferimi të plotë apo të pjesshëm të Interesit të Anëtarit, apo shpërndarjes së pronës së Shoqërisë në favor të Anëtarit të Shoqërisë, kalimi sipas I.R.C. Seksionet 734, 743 dhe 754 për ri-llogaritjen e bazës së Shoqërisë do të kryhet në kohë.

12. Kalimi i Interesave

A. Përveçse kur në këtë dokument shprehet ndryshe, Anëtari nuk do të jetë subjekt i asnjë kufizimi apo ndalimi lidhur me mundësinë e tij për të shitur, caktuar, kaluar, transferuar, ndaluar, përdorë si garanci, apo hequr dorë nga i gjithë ose një pjesë e Interesit të tij në Shoqëri. Pavarësisht nga sa më sipër, në rast se Anëtari kalon të gjithë ose një pjesë të Interesit të tij, personi i caktuar kësaj nga Anëtari nuk do të bëhet një Anëtar Zëvendësues, përveçse: (i) Anëtari e pasqyron një gjë të tillë në instrumentin e kalimit, (ii) i caktuari bie dakord me shkrim që do t'u bindet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dhe (iii) Anëtari dhe i caktuari hartojnë një ndryshim të kësaj Marrëveshjeje dhe hartojnë dhe depozitojnë një ndryshim në Statut (nëse është e nevojshme dhe e përshtatshme), të tillë që secili prej këtyre ndryshimeve do të pasqyrojë, ndër të tjera, pranimin e të caktuarit si Anëtar Zëvendësues dhe, nëse është rasti, dorëheqjen e Anëtarit nga Shoqëria.

B. Pavarësisht nga ndonjë deklaram kundër në këtë Marrëveshje, Anëtari nuk do të ketë të drejtë të pranojë Anëtarë të tjerë në Shoqëri, dhe ndonjë pranim i ndonjë anëtari shtesë sipas këtij § 12B, do të pakësojë, pro rata, të gjithë Interesat e Anëtarit ekzistues në momentin e pranimin në fjalë.

C. Përveçse në rastin kur emërohet në këtë Marrëveshje, apo përndryshe, kur pranohet në Shoqëri në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, asnjë Person nuk do të konsiderohet Anëtar. Shoqëria, Anëtari dhe çdo Person tjetër që bën biznes me Shoqërinë, ka nevojë të bashkëpunojë vetëm me Anëtarët e emëruar dhe të pranuar kësaj; atyre nuk do t'u kërkohet të bashkëpunojnë me ndonjë Person tjetër për

arsye se ky i fundit është i caktuari i ndonjë Anëtari, ose për arsyes të daljes së ndonjë Anëtari nga Shoqëria, përveçse kur në këtë Marrëveshje parashikohet ndryshe.

13. Shpërndarja dhe Mbyllja e Shoqërisë.

A. Shoqëria do të shpërndahet, Aktivet e Shoqërisë do të shiten, çështjet e saj do të mbyllen në rregull, në rastin më të parë kur ndodh ndonjëra prej ngjarjeve në vijim (një “Ngjarje e Shpërndarjes”): është kuptuar dhe rënë dakord që largimi, dorëheqja, falimentimi dhe/ose pamundësia për të paguar borxhet, e Anëtarit, ose ndonjë ngjarje tjetër i ndërprerjes së marrëdhënieve të Anëtarit me Shoqërinë sipas § 4A – 609 të Ligjit, nuk do të përbëjë një Ngjarje të Shpërndarjes:

- (ii) zgjedhja e Anëtarit;
- (iii) kalimi i ndonjë vendimi për shpërndarje, në bazë të Ligjit; ose
- (iv) në atë kohë që Shoqëria nuk ka patur anëtarë për një periudhë prej nëntëdhjetë (90) ditësh të njëpasnjëshme.

B. Shoqëria do të mbyllet kur të gjithë Aktivet e Shoqërisë do të shiten (përveç ndonjë kapitali financiar që nuk mund të shitet), dhe të ardhurat neto prej shitjes, si dhe kapitalet e tjera financiare të Shoqërisë, përveçse kur në këtë Marrëveshje kërkohet ndryshe, do t’u shpërndahen si vijon: (i) së pari, kreditorëve të Shoqërisë për pagimin e, ose përgjigjen ndaj, borxheve të Shoqërisë (përfshirë kreditë, nëse është rasti, që Shoqëria ka marrë nga Anëtari) dhe (ii) së dyti, Anëtarit (pas përcaktimit të të gjithë zërave të Fitimit, Humbjes, të ardhurave nga fitimi, zbritjeve dhe kreditit (apo zërave të tij) në bazë të, dhe sipas Nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje).

14. Dispozita të Ndryshme

A. Përveçse kur këtu parashikohet ndryshe, të gjitha njoftimet që përmenden këtu do të jenë me shkrim, do të dorëzohen doravisht, dhe do të lëshohet vërtetim për marrjen e tyre, ose do të dërgohen me postë rekomande, me postë të klasit të parë dhe me parapagim, ose me postë të shpejtë, në adresën e Anëtarit siç pasqyrohet në Eksponatin A, përveçse kur Shoqëria njoftohet për ndryshim adrese në bazë të dispozitave të këtij § 14A. Çdo njoftim që kërkohet të jepet brenda një periudhe kohe të caktuar do të konsiderohet i kryer në kohë në rast se dërgohet apo vulozet nga posta përpara mesnatës së ditës së fundit të periudhës në fjalë. Çdo njoftim i kryer kështu do të konsiderohet si efektiv për të gjithë qëllimet dhe në të gjithë kuptimet, atëherë kur i është dërguar (ose dhënë) Anëtarit në adresën siç pasqyrohet në Eksponatin A bashkëngjitur, apo në atë adresë tjetër të specifikuar nga Anëtari, njoftimi për të cilën është marrë nga Shoqëria në përputhje me këtë § 14A.

B. Kjo Marrëveshje do të bazohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Shtetit të Maryland-it, pa marrë parasysh parimet e konflikteve ligjore apo përparësisë së ligjeve.

C. Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje gjendet se është e paligjshme, jo e vlefshme apo e pazbatueshme, kjo dispozitë do të hiqet plotësisht nga Marrëveshja; kjo Marrëveshje do të kuptohet dhe zbatohet njëllor sikur kjo dispozitë e paligjshme, jo e vlefshme apo e pazbatueshme nuk ka qenë kurrë pjesë e kësaj Marrëveshjeje, dhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten plotësisht në fuqi dhe do të jenë efektive dhe nuk do të ndikohen nga dispozita e paligjshme, jo e vlefshme apo e pazbatueshme apo nga heqja e saj nga kjo Marrëveshje.

D. Kjo Marrëveshje do të jetë detyruese, dhe do të përshtatet me dobinë e Anëtarit, aksionerëve dhe pasardhësve të tij, dhe, në bazë të dispozitave të Nenit 12 të saj, të caktuarve nga ai.

E. Përveçse kur tekst në mënyrë të qartë jep kuptim tjetër, aty ku është rasti, numri njëjës do të përfshijë shumësin dhe gjinia mashkullore do të përfshijë gjininë femërore ose asnjënjës, dhe anasjelltas, në atë masë që është e nevojshme për t'u dhënë fjalëve të shkruara këtu dhe/ose fjalëve të përdorura në këtë Marrëveshje kuptimin e duhur.

F. Kjo Marrëveshje, Eksponati A bashkëngjitur dhe Statuti, parashtrajnë të gjitha (dhe janë shkruar në mënyrë që të integrojnë të gjitha) premtimet, marrëveshjet, kushtet, kuptimet, garancitë dhe deklarimet që lidhen me Shoqërinë, biznesin e Shoqërisë, Aktivitetin e Shoqërisë, dhe nuk ka premtime, marrëveshje, kushte, kuptime, garanci dhe deklarime, me gojë ose me shkrim, të hapura ose të nënkuptuara, përveç atyre që parashtrohen këtu.